



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:027285

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05535069

**P.nr.260/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit I. H. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.492/23 të datë 31.01.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 14.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të akuzuarit I. H., me datë 14.03.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 02.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri I. H, i biri i B..... dhe nëna H...., e gjinisë A....., i lindur me ....., në F.... K....., me vendbanim në Lagjen nr.... ne F.... K....., me numër personal ....., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, nuk ka te kryer shkolle, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashakali, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datë 03.09.2022, rreth orës 09:05 minuta, në rrugën ”.....”, në F..... K....., saktësisht në oborrin e kompanisë “.....”, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, ka kryer vjedhje në atë mënyrë që ka hyrë brenda në oborr të kompanisë dhe nga rimorkio e një kamionetës pronë e të dëmtuarit H. T. ka vjedhur mjete pune si: një Hilt makita, një metër laserike, një metër e dorës, si dhe shtatë burgia, me të cilin veprim të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë prej (treqind e pesëdhjetë euro) 350 €uro.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 42, 43, 70, 71, 72 dhe 313 par 1 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

**GJYKON**

- I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi dhe
- II. Me dënim me gjobë në shumen prej 300.00 (treqind) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- III. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- IV. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. Pala e dëmtuar H. T. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet që ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.492/23 të datë 31.01.2023, ndaj të akzuarit I. H. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 14.03.2024 në praninë e prokurorit të shtetit E. R dhe të pandehurit I.H. ku pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit I. H. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprat me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoj faktin se i pandehuri ishte i dënuar më parë sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm PM.237/2015 dhe ka precedent penale për vepra penale të llojit të njëjti në numër të madh e për të cilat është shpallur fajtor dhe është dënuar nga kjo Gjykatë.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 42 dhe 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjti të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.260/23 datë 02.04.2024

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

---

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.